



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:141469  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05847402  
CN.nr.71/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Berat Spahiu, në çështjen jokontestimore të propozuesit S.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për caktimin e kujdestarisë ndaj personit dhe pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, jashtë seances gjyqësore, më datë 21.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Gjilan, shpallet me inkompetencë lëndore për të vepruar në këtë çështje dhe hedhet poshtë si i palejuar propozimi i propozuesit S.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për caktimin e kujdestarisë ndaj personit dhe pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme të kundërpropozuesit S.J nga fshati ...-Komuna e Gjilanit.

A r s y e t i m

Propozuesi S.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, në këtë gjykatë ka ushtruar kërkesë me propozim për caktimin e kujdestarisë ndaj personit dhe pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme të kundërpropozuesit S.J nga fshati ...-Komuna e Gjilanit. Gjykata pas shqyrtimit paraprak të propozimit e bazuar në nenin 236 të Ligjit për Familjen i Kosovës / Ligji Nr. 2004/32 Më 16 shkurt 2006 UNMIK/REG/2006/7, ku është përcaktuar se „Personit nën kujdesje, Organi i Kujdestarisë ia cakton kujdestarin. (2) Si kujdestar mund të jetë çdo person i cili i ka cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të kujdestarit dhe i cili më parë jep pëlqimin që të bëhet kujdestar. (3) Kujdestari në radhë të parë caktohet nga mesi i personave në familjen e personit nën kujdestari. Organi i Kujdestarisë do të vendosë nëse kjo gjë është në interes të të kujdesurit”, që në përmbajtje këto dispozita përcaktojnë kompetencën e Organit të Kujdestarisë- Qendrës për Punë Sociale, për të zhvilluar procedurën e caktimit të kujdestarit të personit dhe pasurisë, andaj, gjykata në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore dhe nenit 18 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku është përcaktuar se „ Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore. 18.2 Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t'i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur” gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e hedhë poshtë propozimin si të palejueshëm konform nenit 18.2 të LPK-së..

Nga të lartëcekurt, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:141469  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05847402

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2024:141469, 21.06.2024**

Gjyqtari,  
Berat Spahiu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimi të vendimit, përmes kësaj gjykate.